



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 3.2.2023

Lënda: Bisedimet përfundimtare të Komisionerit Publik para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për çështjen ankim kundër vendimit nr. 275/2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo)

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në përfundim të seancës gjyqësore publike të datës 24.1.2023, që i përket ankimit të Komisionerit Publik, kundër vendimit nr. 275, datë 20.7.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, u vendos të çelet hetimi gjyqësor i çështjes dhe të pranohen në cilësinë e provës aktet e reja të depozituara nga subjekti i rivlerësimit.

Lidhur me provat e reja të paraqitura nga subjekti dhe të administruara në cilësinë e provës nga Kolegji, Komisioneri Publik deklaroi se do të mbajë qëndrimin e tij gjatë paraqitjes së konkluzioneve përfundimtare. Nisur nga fakti që aktet e lejuara nga trupi gjykues për t’u marrë në cilësinë e provës u inventarizuan në seancë dhe u konfirmuan për marrjen e tyre të plota nga Komisioneri Publik, vlerësojmë të ndalemi në ato prova, të cilat ndikojnë në shkaqet e ankimit, për sa do të trajtohen në vijim.

1. Në lidhje me shkaqet e ankimit që lidhen me zërat e burimeve për krijimin e pasurive

1.I Lidhur me verifikimin e të ardhurave të ligjshme për burimin e deklaruar: “kursime nga pagat”¹, subjekti, ndër të tjera², ka depozituar këto akte:

¹ Të ardhura që kanë shërbyer për krijimin e: (i) pasurisë *apartment banimi*, me sip. 111,87 m²; (ii) *apartment banimi*, me sip. 45.6 m², i ndodhur në Golem – Kavajë dhe (iii) pasurisë *autoveturë “Audi”*, të trajtuara gjerësisht në shkaqet e ankimit.

*1.1 Vendimi nr.*** (***) , datë **.11.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Shkodër, dhe Urdhër ekzekutimi nr.** , datë **.3.2021. Ky vendim ka për objekt detyrimin e palës së paditur *** ** sh.p.k., të paguajë kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, dhe detyrimin për tatimin mbi të ardhurat personale, për periudhën **.7.2011 deri më datë **.12.2011, kundrejt paditësit ***.***, bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.*

*1.1.1 Me këtë vendim, gjykata ka pranuar pjesërisht kërkesëpadinë dhe detyrimin e palës së paditur të paguajë në favor të palës paditëse ***.***.***, për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe detyrimin mbi tatimin për të ardhurat personale, për periudhën **.7.2011 deri në datën **.11.2011. Ky vendim ka marrë formë të prerë dhe për të është nxjerrë urdhër ekzekutimi me nr. **, datë **.3.2021.*

*1.1.2 Gjykata, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] rezultoi e provuar se paditësi ***.*** me të paditurën në këtë gjykim ka lidhur një kontratë pune në mbështetje të Kodit të Punës, konkretisht kontratë nr.*** rep./*** kol., datë **.11.2010, me afat 5-vjeçar, efektet e së cilës fillojnë me datë **.11.2010; **.11.2010, me të drejtë përsëritje me të njëjtat kushte. Sipas vërtetimit të lëshuar nga punëdhënësja “*** ** sh.p.k., ***.***, ka vërtetuar se paditësi ***.*** ka qenë në marrëdhënie pune pranë saj si drejtues teknik deri më **.11.2011 dhe pagë mujore 50.000 lekë në muaj [...]. Paga e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore kryhet nga punëdhënësi, që në rastin objekt shqyrtimi është shoqëria ***.*** sh.p.k., sipas afateve të përcaktuara në ligj.*

*1.2 Vendimi nr. **, datë **.11.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Ky vendim ka për objekt detyrimin e palës së paditur *** ** sh.p.k., të paguajë kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, dhe detyrimin për tatimin mbi të ardhurat personale, për periudhën **.12.2011 deri më datë **.12.2012 kundrejt paditësit ***.***.*

*1.2.1 Me këtë vendim, gjykata ka pranuar padinë e paditësit ***.*** dhe detyrimin e palës së paditur të paguajë për llogari të paditësit kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, dhe tatimin për të ardhurat personale për këtë periudhë. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datë **.1.2021 dhe është dorëzuar për ekzekutim pranë përmbaruesit gjyqësor, ***.***.*

*1.2.2 Gjykata, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] rezultoi e provuar se paditësi ***.***, me profesion inxhinier ndërtimi, ka qenë i punësuar pranë shoqërisë *** ** sh.p.k., për periudhën **.12.2011 deri në datën **.12.2012, si drejtues teknik, pranë kësaj pale. Marrëdhënia midis paditësit dhe palës së paditur është rregulluar me kontratën formale të punës me nr.*** rep./*** kol., datë **.12.2011, me afat deri në datën **.12.2012. Sipas kontratës, paga është përcaktuar në shumën 48.000 lekë, duke marrë përsipër punëdhënësi detyrimin që të paguajë kontributet e sigurimeve shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat [...].*

² Të listuara me numër rendor nga 10-15.

1.3 *Vendimi nr.***, datë **.10.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë dhe vendimi nr.***, datë **.1.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.* Ky vendim ka për objekt detyrimin e palës së paditur “***” sh.p.k., të paguajë kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën **.8.2009 deri më datë **.8.2010, kundrejt paditësit ***.***.

1.3.1 Me këtë vendim, gjykata ka pranuar padinë e paditësit ***.*** dhe detyrimin e palës së paditur të paguajë për llogari të paditësit kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për këtë periudhë. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën **.12.2020 dhe është dorëzuar për ekzekutim pranë përmbaruesit gjyqësor, ***.***³.

1.3.2 Gjykata, ndër të tjera, ka arsyetuar se nga provat e administruara gjatë hetimit gjyqësor rezultoi plotësisht e provuar marrëdhënia e punësimit e paditësit ***.***, pranë palës së paditur shoqëria “***” sh.p.k., gjatë periudhës **.8.2009 - **.8.2010. Pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore përbën një detyrim që buron nga ligji, konkretisht dispozitat e sipër referuara të ligjit “Për sigurimet shoqërore në RSH” dhe Kodi i punës.

1.4 *Vendimi nr.***, datë **.3.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.* Ky vendim ka për objekt detyrimin e palës së paditur *** sh.p.k., të paguajë kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën **.8.2009 deri më datë **.8.2010, kundrejt paditësit ***.***.

1.4.1 Me këtë vendim, gjykata ka pranuar padinë e paditësit ***.*** dhe detyrimin e palës së paditur të paguajë për llogari të paditësit kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën **.8.2009 deri më datë **.8.2010. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datën **.9.2020 dhe është dorëzuar për ekzekutim pranë përmbaruesit gjyqësor⁴.

1.4.2 Gjykata, ndër të tjera, ka arsyetuar si rrethana fakti gjatë hetimit gjyqësor dhe analiza ligjore e mosmarrëveshjes objekt gjykimi, se: [...] *përmbajtja e marrëdhënies së punës ndërmjet palës paditëse dhe të paditurit del e qartë nga kontrata e punës nr. *** rep., datë **.5.2007, në të cilën pasqyrohet objekti dhe detyrimet në raport me sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të punëdhënësit, palë e paditur, afati i kohëzgjatjes së kontratës **.5.2007-**.5.2009, si dhe pagën e punëmarrësit në shumën 50.000 lekë [...].*

1.5 *Komisioneri Publik* mban në konsideratë se objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit, përfshin si kontrollin e saktësisë dhe atë të mjaftueshmërisë së deklarimeve në deklaratat periodike dhe atë “Vetting”, ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur/të tjerë të lidhur me të (pasuri e paluajtshme/e luajtshme/likuiditete).

³ Vërtetim i Përmbaruesit gjyqësor ***.*** me nr.*** prot., datë **.12.2022, se pranë tij ndodhen për ekzekutim vendimet e sipërcituara me kreditor shtetasin ***.***.

⁴ Vërtetim me nr. *** prot., datë **.1.2023, Shërbimit Përmbarimor Tiranë.

1.5.1 Në rrethanat faktike dhe ligjore të dala gjatë hetimit administrativ në Komision, si dhe gjatë shqyrtimit në Kolegj, Komisioneri Publik, në konsideratë dhe të jurisprudencës së Kolegjit⁵, vlerëson se të ardhurat me burim *kursime nga paga* nga marrëdhëniet e punësimit të dokumentuara me kontrata shkresore pune, midis personit të lidhur të subjektit të rivlerësimit, z. ***.***, me shoqëritë e sipërlistuar, plotësojnë kushtet e përcaktuara nga neni D i aneksit të Kushtetutës dhe konsiderohen si të ardhura të ligjshme për efekt të procesit të rivlerësimit.

*1.1.1 Lidhur me të ardhurat e deklaruar të përfituara nga shoqëria “*** ***” sh.p.k.*

1.1.1.1 Lidhur me këtë marrëdhënie punësimi, Komisioneri Publik konstaton se, gjatë seancës gjyqësore të datës 24.1.2023, subjekti i rivlerësimit prapësoi faktin se, megjithëse mungon një kontratë formale/shkresore pune⁶, punësimi i personit të lidhur me të, bashkëshortit, pranë subjektit tregtar “***.***” sh.p.k., provohet nëpërmjet rrethanave të tjera, si dhe faktin se mosdeklarimi i punësimit dhe pagës reale pranë organeve tatimore ka qenë detyrim ligjor dhe përgjegjësi i punëdhënësit, shoqërisë “***.***” sh.p.k., duke pretenduar edhe në këtë rast, mosdijeninë e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj mbi situatën reale të pasqyruar për efekt pagese të detyrimeve ndaj organeve tatimore. Në mbështetje të këtyre pretendimeve, subjekti i rivlerësimit ka sjellë në vëmendje, edhe njëherë, aktet dhe provat e administruara dhe të debatuar gjatë hetimit administrativ në Komision⁷, duke depozituar në seancën gjyqësore në Kolegj edhe disa akte të reja⁸.

1.1.1.2 Komisioneri Publik, në analizë të pretendimeve dhe akteve të depozituara nga subjekti, lidhur me këtë marrëdhënie dhe të ardhurat e personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit, deklaruar në deklaratat periodike të viteve 2006 – 2008, vlerëson se në përfundim të hetimit administrativ, provohet e njëjta situatë faktike mbi sjelljen e personit të lidhur në marrëdhëniet punëmarrës (*bashkëshort i subjektit*)-punëdhënës, sikurse me shoqëritë trajtuar më sipër në këto bisedime, situata që janë gjetur të provuara gjyqësisht dhe për të cilat janë administruar vendimet respektive gjyqësore të formës së prerë, sjellje që lidhet me mungesën e dijenisë dhe mungesën e kujdesit dhe vëmendjes së shtuar, jo detyruese, të personit të lidhur në verifikimin e zbatimit të

⁵ Referohuni vendimit (JR) nr. 6/2022 të Kolegjit.

⁶ Për më tepër referohuni në f. 13-15 të prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, parashtruara në seancën e datës 24.1.2023, në Kolegj.

⁷ Për më tepër referohuni në listimin e 43 akteve, f. 4-7, të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit.

⁸ Gjatë shqyrtimit në Kolegj, subjekti depozitoi në cilësinë e provës: (i) Shkresa nr. *** prot., datë **.12.2021, e Drejtorisë së Arkivit Qendror - Instituti i Sigurimeve Shoqërore Tiranë, lidhur me deklarinim e pagës së ish-administratorit të shoqërisë “*** ***” sh.p.k., z. ***.*** (f. 8, e parashtrimeve); (ii) Shkresa nr. *** prot., datë **.12.2021, e UKKA Kavajë, lidhur me një kërkesë të depozituar nga bashkëshorti i subjektit pranë këtij institucioni (f. 9 e parashtrimeve); (iii) Shkresa nr. *** prot., datë **.2.2022, e OSHEE Durrës, lidhur me të njëjtin fakt si në shkresën e sipërcituar (f. 9 e parashtrimeve); (iv) Shkresa nr. *** prot., datë **.2.2021, e Qendrës Shëndetësore nr. 8, Tiranë, si dhe shkresa nr. *** prot., datë **.3.2021, e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, lidhur me faktin e mospërfitimit të bashkëshortit të subjektit nga skema e kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve të tjera spitalore (f. 12 e parashtrimeve); (v) Shkresa nr. *** prot., datë **.1.2023, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë në lidhje me deklarinimet e subjektit tregtar “***.***” sh.p.k., për kontributet e sigurimeve shoqërore-shëndetësore dhe listën e punonjësve (f. 12 e parashtrimeve); (vi) Shkresa nr. *** prot., datë **.3.2021, e Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore Tiranë, lidhur me disa ndryshime ligjore që ka pësuar Kodi i Punës në vitin 2015 (f. 15 e parashtrimeve); (vii) Dokumente të brendshme të shoqërisë “***.***” sh.p.k., kartela të llogarisë kontabël të pagës së bashkëshortit të subjektit për periudhën 2006-2008 (f. 17 e parashtrimeve).

detyrimeve kontraktuale lidhur me marrëdhënien e punësimit nga ana e punëdhënësit, konform legjislacionit në fuqi.

Komisioneri Publik nënvizon se në këto rrethana nuk kontestohet ekzistenca e marrëdhënies së punësimit mes personit të lidhur dhe shoqërisë në fjalë, as dhe fakti se detyrimi ligjor për shlyerjen e detyrimeve tatimore bie mbi punëdhënësin. Sikundër, sa kohë në situata të ngjashme të marrëdhënies së punësimit me shoqëri të tjera, me vendime gjyqësore të formës së prerë, është gjetur e provuar mungesa e dijenisë së personit të lidhur me këtë rrethanë faktike, parë në harmoni dhe me provat e reja të administruara gjatë këtij gjykimi, edhe kjo rrethanë në këtë marrëdhënie punësimi gjendet e provuar.

Megjithatë, Komisioneri Publik konstaton se në kushtet kur: (i) mungon një akt i shkruar që të provojë rregullimin e marrëdhënies financiare midis palëve në lidhje me vlerën e pagesës; (ii) punëdhënësi ka kryer pagesa të detyrimeve tatimore mbi të ardhura minimale të përfituara në formën e pagës mujore; (iii) deklaratimet e z. ***.*** mbi të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit⁹ janë kontradiktore; lidhur me verifikimin e vlerës reale mujore dhe tërësore të kësaj të ardhure të pretenduar si të përfituar dhe deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DV, ndodhemi në kushtet e pamundësisë objektive të kontrollit dhe përcaktimit, e për pasojë, të llogaritjes së të ardhurave reale të realizuara gjatë viteve 2006-2008, nga kjo marrëdhënie punësimi.

1.1.1.3 Sa më sipër, gjendemi në kushtet e pamundësisë së provimit të burimeve të ligjshme të të ardhurave të ligjshme nga ana e subjektit të rivlerësimit, për mbulimin e plotë të pagesës së pasurisë *apartment banimi*, me sip. 118 m², sipas parashikimeve të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, referuar dhe në jurisprudencën e Kolegjit.

2. Në lidhje me pasurinë “*Apartment banimi me sip. 45,6 m²*”, ndodhur në Kavajë dhe pasurinë *autoveturë*, Komisioneri Publik iu qëndron shkaqeve të ankimit dhe parashtrimeve të datës 24.1.2023, pasi vlerëson se për ligjshmërinë e burimit të krijimit të këtyre pasurive, pretendimet dhe prapësimet e subjektit të rivlerësimit nuk arrijnë të provojnë të kundërtën, qëndrim ky i bazuar në jurisprudencën e Kolegjit mbi trajtimin e kursimeve në *cash*.

2.1 Në seancën gjyqësore të datës 24.1.2023, subjekti i rivlerësimit në prapësimet e paraqitura, pranoi se nuk ka deklaruar burimin e krijimit dhe pakësimin e gjendjes *cash* në DV-2011 në momentin e krijimit të pasurisë *apartment*, datë **.4.2011¹⁰, duke e pretenduar vlerësimin e këtij fakti në kuadrin e një pasaktësie në deklaram.

2.2 Komisioneri Publik, referuar jurisprudencës së përsëritur të Kolegjit, detyrohet të konstatojë se, dhe gjatë hetimit gjyqësor të kësaj çështje në Kolegj, pretendimet e subjektit mbi përdorimin e kursimeve në *cash*, të deklaruara në DV-2010, si burim për krijimin e pasurive dhe

⁹ Në vërtetimin e paraqitur nga shoqëria në dosje të subjektit të rivlerësimit, z. ***.***, në cilësinë e administratorit të shoqërisë “**.*.*.*” sh.p.k., deklaroi pagën e z. ***.***, në shumën 80.000 lekë (të reja), në deklaratën noteriale nr.***, datë **.11.2019, z. ***.*** deklaroi pagën në shumën 80.000 lekë neto, ndërsa në procesverbalin e mbajtur në Komision gjatë hetimit administrativ, z. ***.***, në cilësinë e dëshmitarit deklaroi se paga e z. ***.*** [...] në tërësi ka qenë 80 mijë lekë. Pastaj, ai paguante të tjerat. Se punët financiare nuk i di [...].

¹⁰ Për më tepër referohuni f. 39, të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, të datës 24.1.2023.

në mbulimin e shpenzimeve deri në datën **.4.2011, mbeten në nivel deklarativ. Duke iu qëndruar parashtrimeve të paraqitura në seancën e kaluar gjyqësore për këtë shkak ankimor, mosdeklarimi nga ana e subjektit e pakësimit të kursimeve të disponuara në *cash*, si burim për blerjen e pasurive deri në datën **.4.2011, çon në pamjaftueshmëri financiare të subjektit dhe personave të lidhur me të, për një diferencë negative deri në datën **.4.2011, në shumën – 849.435 lekë.

3. Për sa iu përket shkaqeve të ankimit mbi konstatimin e diferencave negative edhe për vitet 2012 dhe 2015, *Komisioneri Publik*, pasi analizoi prapësimet dhe aktet e vëna në dispozicion nga subjekti gjatë shqyrtimit në Kolegj, vlerëson se, bazuar në Vendimin gjyqësor të formës së prerë nr.*** (***), datë **.11.2020, të Gjykatës së Rrethit Shkodër dhe atë nr. ***, datë **.11.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, në konsideratë të përfshirjes së të ardhurave nga pagat e bashkëshortit të subjektit sipas dy vendimeve respektive, përmbysset diferenca negative e vitit 2012 dhe ngelet në fuqi diferenca negative e konstatuar për vitin 2015, për një diferencë negative në shumën –262.968 lekë, pasi, sikundër trajtuar dhe më sipër, në rastin e pasurisë nr. 2, pretendimet e subjektit mbi mosdeklarim të saktë të kursimeve në *cash* (*konkretisht pakësimit dhe përdorimit të tyre*) mbeten në nivel deklarativ, referuar me jurisprudencën e Kolegjit për raste të ngjashme.

4. Kërkimi përfundimtar i ankimit

Duke përfunduar për sa parashtruam, Komisioneri Publik, bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkojmë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 275, datë 20.7.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeleda Osmani (Xhengo).

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA